



Pranuar / Dorezuar Puniljevoj/Prizdato Received/Delivered	23. 03	2022	2	viti god year
Organ / Niveli Organ / Jedini Org / Unit	SKPTJHCK	1539/22	1/3	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.143/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.143/2022 të datës 18.02.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë Prishtinë, kundër Vendimit me numër 14-070/01-89001/21 të datës 20.05.2021 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prishtinës, në çështjen juridike-administrative "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

Pezullohet procedura lidhur me ankesën me numër A.nr.143/2022 të datës 18.02.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi tani i pensionuar, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 846/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Vendimit me numër 14-070/01-89001/21 të datës 20.05.2021 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prishtinës, me pretendimin ankimor që ti njihet e drejta e kompensimit të tri (3) pagave jubilarë dhe shujtave konform dispozitave ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 23.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Komuna e Prishtinës, ndërsa me datë 14.03.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 143/2022 të datës 18.02.2022 të parashtruar nga ankuesi ne Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër 14-118/02-63324/2021 të datës 07.04.2021 për përfundimin e marrëdhënies së punës me rastin e pensionimit të ankuesit; Vendimin me numër 14-070/01-89001/21 të datës 20.05.2021 te Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në komunën e Prishtinës; Aktvendimin me numër A.nr.1308/2021 të Gjykatës Themelore ne Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative; Dëshminë (fletë kthesën) e datës 15.02.2022 lidhur me pranimin e aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 963/2022 të datës 23.02.2022 të Këshillit te Pavarur Mbikëqyrës; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1327/2022 të datës 14.03.2022 të Komunës së Prishtinës; Aktin e emërimit me numër 112-648 të datës 13.03.2017 të ankuesit;

Bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndë, rrjedhe së ankuesi ka qenë i punësuar në Komunën e Prishtinës në pozitën *Zyrtar Teknik i Ndërtimitarisë*. Me Vendimin me numër 14-118/02-63324/21 të datës 07.04.2021 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, ankuesit i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit me datë 01.05.2021. Kundër këtij vendimi, ankuesi me datën 20.05.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prishtinës, për shkak të mos pagesës së tri pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse.

Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave me datë 31.05.2021 ka nxjerrë Vendimin me numër 14-070/01-89001/21 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar, duke udhëzuar të njëjtin që kundër këtij vendimi mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Ankuesi kundër Vendimin me numër 14-070/01-89001/21 të e datës 31.05.2021 të Komisionit për Zgjedhjeve dhe Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prishtinës ka hap konflikt administrativë pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 16.12.2021 përmes Aktvendim A.nr.1308/2021, me të cilin obligohet paditësi (ankuesi në këtë rast) që të bëjë precizimin e padisë në kuptimin subjektiv (si i paditur Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës) në afat prej 8 ditësh.

Pas pranimin të Aktvendimit A.nr.1308/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ankuesi me datë 18.02.2022 me ankesë i drejtohet Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër 14-070/01-89001/21 të datës 20.05.2021 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prishtinës, me pretendimin ankimor që ti njihet e drejta e kompensimit të tri (3) pagave jubilarë dhe shujtave konform dispozitave ligjore.

Andaj, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke marr parasysh se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me Aktvendimin A.nr.1308/2021 të datës 16.12.2021 ka kërkuar nga ankuesi në cilësi të paditësit që te bej precizimin e ankesës në aspektin subjektiv, dhe meqenëse Gjykata nuk ka vendosur në mënyrë përfundimtare lidhur padinë e ankuesit, Kolegji



në mbështetje të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: "Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: "çështje paraprake"), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit", si dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për pezullim të procedurës në lidhje me ankesën 143/22.

Procedura lidhur me ankesën A.nr.143/2022, do të mbetet e pezulluar deri në vendosjen përfundimtare të kësaj çështjes në gjykatën kompetente.

Duke u bazuar si me lartë, dhe në mbështetje të nenit nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicini i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.143/2022

Ilire Mehmeti Shaqiri


Procesmbajtëse


Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Njesisë për Burime Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.